
RAPORT
I ADMINISTRATOREVE TE SHOQERISE
"UNION GRUP" Shpk

Objekti: Raport mbi propozimin e shnderrimit te formes aktuale te shoqerise, ne shoqeri aksionare

1. Aresyet per shnderrimin

Shoqeria "UNION GRUP" eshte nje shoqi e themeluar dhe regjistruar sipas Ligjit nr.9901/2018 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ndryshuar, ("**Ligi per Shoqerite Tregtare**") ne formen e shoqerise me perjegjesi te kufizuar (**Shoqeria**). Sipas dispozitave ligjore te cilat rregullojn organizimin dhe funksionimin e shoqerive me perjegjesi te kufizuar, struktura organizative e ketyre shoqerive, per sa i perket organeve drejtuese te shoqerise, eshte ajo e funksionimit te Asamblese se Pergjitheshme (*si organi vendimarrres i cili mbledh bashke zoteruesit e kapitalit te shoqerise*), dhe te Administratorit, (*si organi menaxhues dhe implementues i aktivitetit te perditshem tregtar te shoqerise*). Nje strukture e tillte e thjeshtezuar eshte e dobishme ne kuadrin e lethesise se vendimarrjes se brendshme si dhe rezulton e pershtashme per aktivitetet tregtare kompleksiteti i te cilave nuk kerkon nje organizim te detajuar dhe te degezuar te kompetencave.

Ne kuadrin e zhvillimit te aktivitetit tregtar te Shoqerise si pjese e realizimit te objektit te saj statutor, veprimtaria e Shoqerise duke qene e fokusuar ne aktivitetin e zoterimit dhe kontrollit te kapitalit te shoqerive te tjera nepermjet pjesemarrjes, ndjekjes dhe kontrollit te ketyre shoqerive, si ne aspektin e karakterit financiar, teknik ashtu edhe konsultativ, kerkon nje strukture organizative te brendshme e cila do t'i lejonte nje detajim dhe degezim me te qarte dhe me te formalizuar te kompetencave per sa i perket administrimit dhe mbikeqyrjes te aktivitetit te shoqerise.

Ne kuadrin e identifikimit te kesaj nevoje, forma e shoqerise aksionare me nje strukture me te gjere dhe njekohesisht me te formalizuar, do t'i lejonte Shoqerise te operonte me lethesisht ne organizimin e brendshem per sa i perket administrimit te aktivitetit dhe funksioneve te mbikeqyrjes dhe kontrollit duke ofruar mundesine e krijimit te nje strukture kolegiale e cila jo vetem ne teresi, si nje organ i vetem, do te kishte kometanca te qarta te caktuara nga ligji dhe statuti, por do te mund te krijonte ne brendesi te saj edhe struktura te tjera me te ngushta, ne varesi te çeshtjeve apo nevojave te caktuara.

Ne kete kuader, krijimi i një Keshilli Administrimi me disa anetare, dhenia e kompetencave administruese, mbikeqyrese dhe kontrolluese anetareve te tjere, krijon ne klime korporative me transparente e cila ndihmon ne efikasitetin e qeverisjes korporative te Shoqerise, ofron nje strukture te fuqishme e afte te perballoje intensitete te larta te aktivitetit te Shoqerise si dhe permireson rrjedhshmerine e ushtrimit te funksioneve midis Administratorit, Keshillit te Administrimit dhe Asamblese se Pergjitheshme.

Legjislacioni shqiptar e ben te mundur nderrmarjen e nje procesi te tille shnderrimi ne nenet 228 dhe 229 te tij. Nga ky proces, nuk pritet te rezultoje asnje prekje e struktura se zoterimit te kapitalit apo e vleres ekonomike te pjeseve te kapitalit,asnje cenim te te drejtave te kreditoreve apo kontraktoreve duke qene se shnderrimit nuk nderpret ne asnje moment egzistencen e shoqerise si dhe te drejtat dhe detyrimet qe ajo mbart kundrejt te treteve, si dhe asnje nevoje per nderrmarje te pushimeve kolektive nga puna.

2. Kapitali i Shoqerise dhe aksionet

2.1 Shnderrimi i kuotave ne aksione

Aktualisht kapitali i shoqerise eshte 14.761.377 Leke, eshte i ndare dhe i zoteruar nga 5 ortake. Me procesin e shnderrimit, nuk do te pesonte ndryshim vlera e kapitalit themeltar te Shoqerise, dhe as vlera e pjesemarrjes se secilit ortak. Gjithsesi tashme kapitali i saj do te ndahet ne 100 aksione, me vlore nominale 147,613.77 Leke dhe numrat e permendor dhe kapitali i shoqerise aksionare do te rezultonte i strukturuar si me poshte:

- Kapitali 14.761.377 Leke;
- 100 Aksione;
- vlera nominale e nje aksioni: 147,613.77 Leke

Si resultat i ketij shnderrimi,asnje nga vlerat e perqindjes se pjesemarrjes ne kapitalin akionar nga ortaket aktual nuk do te ndryshonte.



2.2 Kategorite e aksioneve

Ne kuader te ketij shnderrimi qe propozohet, Shoqeria ne zbatim te neneve 116, 122, 128, dhe 135/1/(g), te Ligjit per Shoqerite Tregtare, ka per qellim krijimin e dy kategorive te aksioneve:

- **80 aksione te zakonshme**, me nje vlore te perqjitheshme prej 11.809.101, 56 leke, te cilat perbjne 80% te kapitalit te shoqerise;
- **20 aksione me perparesti pa te drejte vote**, me nje vlore te perqjitheshme prej 2.952.275, 54 leke, te cilat perbjene 20% te kapitalit te shoqerise;

aksionet e zakonshme do te zoterohen si me poshte:

Z. Edmond Leka - 35 aksione te zakonshme ne nje vlore prej **5.166.483, 00 Leke**, te cilat perbejne **35%** te kapitalit te Shoqerise;



Z. Niko Leka – 35 aksione te zakonshme ne nje vlore prej **5.166.483, 00 Leke**, te cilat perbejne **35%** te kapitalit te Shoqerise;

Z. Varuzhan Piranjani – 10 aksione te zakonshme, ne nje vlore prej **1.476.137,00 Leke** te cilat perbejne **10%** perqind te kapitalit te Shoqerise;

akcionet me perparesi pa te drejte vote do te zoterohen si me poshte:

Z. Gjergji Misha – 10 aksione me perparesi pa te drejte vote, ne nje vlore prej **1.476.137, 00 Leke** te cilat perbejne **10 %** te kapitalit te Shoqerise;

Z. Eduard Shima - 10 aksione me perparesi pa te drejte vote, ne nje vlore prej **1.476.137, 00 Leke** te cilat perbejne **10 %** te kapitalit te Shoqerise;

2.3 Te drejtat per cdo kategori te akacioneve

Aksionet e zakonshme do te kene te gjitha te drejtat te cilat i njeh Ligji per Shoqerite Tregtare.

Akcionet me perparesi pa te drejte vote, do te kene te drejtat e meposhtme:

- perparesi ne shperndarjen e dividentit sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare. Aksionaret te cilet zoterojne kete kategori aksionesh, do te perfitojne vleren e dividentit qe i takon ne baze te perqindjes ne kapital, perpara shperndarjes se dividentit tek aksionaret e zakonshem;
- perparesi ne ndarjen e pasurive te Shoqerise te mbetur pas likujdimit;
- nuk do te kene te drejten e votes ne Asamblene e Pergjitheshme per cfareadoljoj ceshtje, pervec rasteve te parashikuara ne ligj;

3. Votimi ne Asamblene e Pergjitheshme te Shoqerise

Te drejtat e votes ne Asamblene e Pergjitheshme do te ushtrohen vetem nga aksioneret te cilet zoterojne 80 aksionet e zakonshme. Ne perputhje me parashikimet ligjore, per qellimin e llogaritjes se kuorumi dhe te votave te cilat nevojiten per miratimin e vendimeve, perqindja e te drejtave te votes ne Asamblene e Pergjitheshme per secilin nga aksionaret me te drejte vote do te hete si me poshte:


Z. Edmond Leka ka 43.75% te votave ne Asamblene e Pergjitheshme:

Z. Niko Leka ka 43.75% te votave ne Asamblene e Pergjitheshme;

Z. Varuzhan Piranjani ka 12.5% te votave ne Asamblene e Pergjitheshme;

4. Te drejtat dhe detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve

Shnderrimi i formes ligjore te Shoqerise nuk perben asnjë nderprerje te egzistences se saj dhe nuk perben asnjë nderprerje te te drejtave te zoteraura prej saj apo te detyrimeve kundrejt te treteve.



5. Punonjesit e Shoqerise


Nga shnderrimi i formes se Shoqerise nuk pritet asnje reduktim i punonjesve dheasnje proces i pushimit kolektiv nga puna.

6. Konkluzione

Nga vleresimi i elementeve kryesore te shnderrimit te formes se shoqerise nga ajo me perqegjesi te kufizuar ne shoqeri aksionare, nuk priten efekte ne vleren e kapitalit te shoqerise, vleren dhe perqindjet e pjeseve te zoteraura nga ortaket, ne te drejtat dhe detyrimet e shoqerise kundrejt te treteve si dhe efekte ne numrin e punonjesve. Shnderrimi do te kishte efektin e organizimit te ri te brendshem te struktura se Shoqerise dhe ndarjes se funskioneve.


Date 29.08.2018

Niko Leka



Administratoret

Edmond Leka





STATUTI
I
SHOQERISE AKSIONARE
UNION GRUP SH.A.

KREU I
Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja
Neni 1.
Forma, Emri i Shoqerise dhe Percaktime

- 1.1. Kjo shoqeri ka formen e shoqerise aksionare dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me dispozitat e Ligjit (si eshte percaktuar me poshte), me legjislacionin shqiptar ne fuqi, si dhe me ndryshimet e tyre te here pas hereshme.
- 1.2. Emertimi i shoqerise eshte "**UNION GRUP SH.A.**"
- 1.3. Ne kete statut, termat e meposhtem do te kene kuptimin e percaktuar ne vijim:
 - (i) "Ligji" do te thote Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", i ndryshuar;
 - (ii) "Shoqeria" do te thote UNION GRUP SH.A;
 - (iii) "Statuti" do te thote statuti i Shoqerise.

Neni 2.

Selia

- 2.1 Selia e shoqerise ne momentin e miratimit te ketij statuti eshte ne adresen: Rruga "Ismail Qemali", nr. 32, kati 3, Njesia Bashkiake nr. 5, Kodi postar 1019, Tirane, Shqiperi.
- 2.2 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Republikes se Shqiperise. Shoqeria, me vendim te Keshillit te Administrimit, mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 3.

Kohezgjatja

- 3.1 Kohezgjatja e veprimitarise se Shoqerise eshte e pakufizuar.

Neni 4.

Objekti i Shoqerise

- 4.1 Shoqeria do te kryeje aktivitetin e me poshtem:

Pjesmarja, ndjekja dhe kontrolli i pjesmarrjes ne pronesine e shoqerive te tjera, ku ajo gezon te drejten e pronesise.

Kreu II

Kapitali i Regjistruar / Aksionet

Neni 5.

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i Shoqerise, ne momentin e miratimit te ketij Statuti, eshte 14.761.377 Leke, (katermbedhjete milion e shtateqind e gjashtedhjete e nje mijë e treqind e shtatedhjete e shtate) Leke, i perbere nga 100 aksione, me vlore nominale 147,613.77 Leke secili.
- 5.2 Shoqeria ne zbatim te neneve 116, 122, 128, dhe 135/1/(g), te Ligjit per Shoqerite Tregtare, ka dy kategori te aksioneve:
- **80 aksione te zakonshme**, te cilat perbjne 80% te kapitalit te shoqerise;
 - **20 aksione me perparesti pa te drejte vote**, te cilat perbjene 20% te kapitalit te shoqerise;
- 5.3 Pjesemarrja e aksionareve ne kapitalin e shoqerise, ne momentin e miratimit te ketij statuti, eshte si me poshte:
- 5.3.1 Aksionet e zakonshme do te zoterojen si me poshte:
- Z. Edmond Leka** - 35 aksione te zakonshme, te cilat perbejne 35% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Niko Leka** - 35 aksione te zakonshme, te cilat perbejne 35% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Varuzhan Piranjani** - 10 aksione te zakonshme, te cilat perbejne 10% te kapitalit te Shoqerise;
- 5.3.2 Aksionet me perparesti pa te drejte vote do te zoterojen si me poshte:
- Z. Gjergji Misha** - 10 aksione me perparesti pa te drejte vote, te cilat perbejne 10 % te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Eduard Shima** - 10 aksione me perparesti pa te drejte vote, te cilat perbejne 10 % te kapitalit te Shoqerise;



Neni 6.

Shlyerja e aksioneve

- 6.1. Ne momentin e miratimit te ketij statuti, te gjithe aksionet e emetuara si me siper jane paguar plotesisht nga aksionaret.

Neni 7.

Kategorite e Aksioneve, te Drejtat dhe Kufizimet

7.1 Aksionet aktuale te Shoqerise jane te ndara ne 2 kategori: aksione te zakonshme dhe aksione me perparesi pa te drejte vote.

7.2 Cdo aksion i zakonshem i Shoqerise jep te drejten e nje vote.

7.3 Ne perputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga aksionet ekzistuese, aksionet e reja mund te emetojen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te miratuar ne perputhje me parashikimet e neneve 145 dhe 149 te Ligjit.

7.4 Te drejtat per cdo kategori te aksioneve:

7.4.1 Aksionet e zakonshme do te kene te gjitha te drejtat te cilat i njeh Ligji per Shoqerite Tregtare.

7.4.2 Aksionet me perparesi pa te drejte vote, do te kene te drejtat e meposhtme:

(a) perparesi ne shperndarjen e dividentit sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare. Aksionaret te cilet zoterojne kete kategori aksionesh, do te perfitojne vleren e dividentit qe i takon ne baze te perqindjes ne kapital, perpara shperndarjes se dividentit tek aksionaret e zakonshem;

(b) perparesi ne ndarjen e pasurive te Shoqerise te mbetura pas likujdimit;

(c) nuk do te kene te drejten e votes ne Asamblene e Pergjitheshme per cfare dolloj ceshtje, pavec rasteve te parashikuara ne ligj;

7.5 Ne kuptim te nenit 145, paragrafi 3, i Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, vlefshmeria e vendimeve, qe percaktojne detyrime shtese mbi aksionaret apo vendimet, qe kufizojne te drejtat e tyre, te parashikuara ne kete ligj, ne statut apo ne vendime te tjera, kushtezohet nga miratimi i aksionarit perkates.

Neni 8.

Registri i aksionareve dhe Certifikatat e aksioneve

- 8.1 Keshilli i Administrimit do te hartoje dhe mbaje nje regjister te aksionareve te Shoqerise ne seline e Shoqerise, i cili duhet te permbate: emrin, mbiemrin dhe te dhenat identifikuase personale te aksionarit ose, nese aksionari eshte person juridik, emertimin dhe te dhenat identifikuase te personit juridik, numrin e aksioneve dhe kategorine e tyre, vleren nominale te tyre, adresen ose seline e aksionareve dhe daten e kryerjes se regjistrimit te aktit. Adresa e komunikuar Shoqerise nga aksionari me shkrim, ne formen e aktit notarial, dhe e regjistruar ne regjistrin e mesiperme, do te prezumohet si adresa e tij zyrtare ne te cilin do te dergohen te gjitha komunikimet ne lidhje me Shoqerine dhe/ose kete statut deri ne momentin kur aksionari do t'i njoftonte Shoqerise me shkrim (ne formen e aktit notarial) ndryshimin e saj.
- 8.2 Secili aksionar ka te drejte te kerkoje nje certifikate per aksionet e zoteruar prej tij. Certifikata nuk do te gezoje cilesine e letres me vlere. Aksionaret e Shoqerise autorizojn shprehimisht, me hyrjen ne fuqi te ketij statuti, perfaquesuesin ligjor te Shoqerise te leshoje certifikata aksionare ne perputhje me regjistrin e aksionareve.

Neni 9.

Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmadhoje kapitalin themeltar te Shoqerise, nepermjet kontributeve ne para ose ne natyre, ne vleren e percaktuar ne vendimin perkates, ne perputhje me Ligjin.
- 9.2 Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltar te saj me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar te votave dhe ne perputhje me parashikimet e Ligjit.

Neni 10.


Trasferimi i te drejtave te lidhura me Aksionet dhe i pronesise se tyre

- 10.1 Pervecse kur miratohet me voten pro te aksionareve qe perfaqesojne 75% te kapitalit:
- (i) asnje e drejte reale dhe/ose personale mbi aksionet apo qe rrjedh prej tyre, nuk do t'i jepet apo transferohet nje pale te trete; dhe
 - (ii) nuk mund te kryhet transferimi i se drejtes se pronesise mbi aksionet e zoteruara nga nje aksioner, pa shperblim, *inter vivos*.

- 10.2 Titulli i pronesise mbi aksionet, kundrejt pageses, mund t'i transferohet paleve te treta, te cilat nuk jane aksionare te Shoqerise, *inter vivos*, ne perputhje me procedurat ketu te percaktuara.
- 10.3 Cdo aksionar i cili deshiron te transferoje te drejtat e tij mbi nje apo me shume aksione qe ka ne pronesi ("Shitesi"), duhet paraprakisht te njoftoje me shkrim (i) Shoquerine, ne vemandje te Administratorit dhe Keshillin te Administrimit dhe (ii) te gjithe aksionaret e tjere ("Aksionaret e Tjere"), duke derguar nje leter rekomande ("Njoftimi") ne seline e Shoqerise dhe ne adresat e aksionareve sikurse te regjistruara ne regjistrin e aksionareve. Ne rast te kundert, Njoftimi do te konsiderohet i pavlefshem.
- 10.4 Njoftimi duhet te specifikoje: (a) emrin e bleresisit; (b) aksionet e ofruara dhe (c) cmimin e rene dakord per cdo aksion. Cdo kusht dhe term shtese per te cilet eshte rene dakord mes Shitesit dhe pales se trete do te jete detyrues kundrejt aksionareve te cilet ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes.
- 10.5 Brenda 20 (njezet) diteve kalendarike nga marrja e njoftimit, Keshilli i Administrimit duhet te shprehe refuzimin e tij me shkrim ne lidhje me transferimin e aksioneve te Shitesit duke ia komunikuar Shitesit dhe Aksionareve te Tjere. Ne te kundert, do te prezumohet qe Keshilli i Administrimit e ka miratuar transferimin e aksioneve te treteve ne fjale. Nese refuzimi i Keshillit te Administrimit eshte i motivuar, Shitesi nuk mund t'i transferoje aksionet e tij te treteve dhe nuk lind asnje detyrim per Shoquerine per te mundesar blerjen e ketyre aksioneve. Do te konsiderohet nje refuzim i motivuar rasti kur Keshilli i Administrimit refuzon transferimin e aksioneve te Shitesit tek i treti/ te tretet nese ky i fundit (i) ushtron, direkt ose indirekt, nje aktivitet konkurruesh ose ka nje konflikt interes i Shoquerine ose me ndonje nga Shoquerite e grupit influencues ne te cilin ben pjese Shoqeria, ose (ii) eshte i denuar penalish me nje vendim Gjyqate te formes se prere ose eshte, sidoqofte, ne cilesine e te paditurit ne nje proces gjyqesor ose hetimor qe ka si objekt shqyrtimin e akuzes se kryerjes se nje vepre penale per te cilin Kodi Penal parashikon teorikisht nje denim maksimal jo me te ulet se 1 vjet heqje lirie ose (iii) personalisht ose nje prej shoqerive te kontrolluara prej tij (ku ka kontrolluar 50% +1 te drejta vote) eshte shpallur me perpara i falimentuar ose eshte aktualisht ne proces falimentimi. Nese refuzimi i Keshillit te Administrimit eshte i pamotivuar, Shitesi eshte i lire t'i shese aksionet e veta te tretit, me perjashtim te rastit kur Shoqeria ben te mundur qe aksionet target te blihen nga dikush tjeter, aksionar ose jo, ose ofrohet te bleje aksionet e veta per te njejtin cmim, kushte dhe terma te parashikuara ne Njoftim, brenda kufijve te lejuar nga Ligji dhe ky statut. Shoqeria mund te bleje aksionet e veta me kusht qe (i) aksionet target te jene te shlyera plotesisht dhe (ii) cmimi te paguhet nepermjet rezervave te disponueshme, sipas pasqyrave financiare te fundit te miratuara. Ne kete rast, Shoqeria brenda 1 viti nga blerja e

- aksioneve te veta duhet t'i shese ose t'i anulloje, aksionet e veta sipas nenit 186 te Ligjit dhe t'i cregjistroje nga regjistri i aksioneve. Pavaresisht nga sa me siper, Shoqeria nuk mund te ushtroje, per aksionet e veta, te drejtat qe sipas Ligjit rrjedhin nga zoterimi i tyre.
- 10.6 Aksionaret e Tjere kane te drejte te blejne te gjitha, por jo pjese te aksioneve te ofruara, me te njejtin cmim te shenuar ne Njoftim nese transferimi i ketyre aksioneve te treteve eshte lejuar nga Shoqeria ose eshte refuzuar ne menyre te pamotivuar.
- 10.7 Nese Aksionaret e Tjere kane si qellim te ushtrojne te drejten e parablerjes, secili prej tyre duhet te njoftoje Shitesin permes nje letre te rekomande me kthim per gjigje, e cila duhet te dergohet brenda 40 diteve kalendarike prej dites se marrjes se Njoftimit. Nese sa me siper nuk do te njoftohet brenda afatit te mesiperm, e drejta e parablerjes do te konsiderohet si e doreheqr.
- 10.8 Ne rastin kur e drejta e parablerjes ushtrohet, Shitesi duhet te transferoje pronesine e aksioneve tek Aksionari Tjeter (i cili ka ushtruar te drejten e parablerjes) dhe cmimi perkates duhet te paguhet nga ky i fundit ne favor te Shitesit, brenda 40 diteve kalendarike duke filluar nga skadanca e periudhes per gjate seciles mund te ushtrohet kjo e drejte e parablerjes. Nese cmimi ne fjale nuk paguhet brenda afatit te mesiperm, e drejta e parablerjes se ushtruar humb cdo efekt.
- 10.9 Nese me shume se nje prej Aksionareve te Tjere ka ushtruar te drejten e parablerjes, aksionet e ofruara do te blihen prej ketyre Aksionareve ne perpjesetim te drejte me aksionet perkates qe ata kane pronesi ne Shoqeri.
- 10.10 Nese asnje prej Aksionareve te Tjere nuk ka ushtruar te drejten perkatese te parablerjes brenda afatit te siperpercaktuar, Shitesi do te kete te drejte t'i shese aksionet e specifikuara ne Njoftim tek pala e trete me cmimin aty te percaktuar brenda 30 (tridhjete) diteve kalendarike nga mbarimi i afatit te parashikuar ne nenin 10.7 me siper.
- 10.11 Kushtet e parashikuara ne kete Statut nuk do te zbatohen tek marreveshjet e transferimit ne rastin kur subjektit te cilit i transferohen aksionet;
- eshte nje shoqeri drejtpersedrejti apo terthorazi e kontrolluar, prej transferuesit/ve vetem ose bashkarisht me nje prej aksionareve te tjere te Shoquerise;
 - eshte nje shoqeri e cila drejtpersedrejti apo terthorazi kontrollon transferuesin/at; apo
 - subjektit/et te cilit i eshte kryer transferimi dhe transferuesi/at jane nen kontrollin e perbashket te nje shoqerie te trete;

per sa kohe eshte dhene evidence per kontrollin sub (i), (ii) ose (iii).



Per me shume qartesi, aksionaret deklarojne se per qellimin e kesaj dispozite stutte, "kontroll" do te thote te zoterosh direkt ose indirekt shumicen absolute te votave ne Asamblene e Pergjithshme te shoqerise target (d.m.th. 50% plus 1 vote)

- 10.12 Ne te gjitha rastet e tjera kur ky statut ose Ligji nuk ndalojne ose kufizojne shprehimisht transferimin e aksioneve, aksionet mund te transferohen lirisht.

KREU III

Neni 11.

Organet e Shoqerise

- 11.1 Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Keshilli i Administrimit;
- 3) Administratori/et dhe
- 4) Eksperti Kontabel i Autorizuar.

Asambleja e Pergjithshme

Neni 12.

Pjesemarrja dhe perfaqesimi

- 12.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithe aksionaret e saj.
- 12.2 Cdo aksionar ka te drejten te marre pjese ne Asamblee Pergjithshme, te shprehe mendimin e tij dhe te ushtroje te drejten e votes qe buron nga aksionet qe zoteron. Gjithsesi, asnje aksionar nuk do te votoje ne mbledhjen e Asamblee se Pergjithshme, personalisht ose nepermjet perfaqesuesve, ne lidhje me aksionet e zotruara prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me aksionet brenda afateve te percaktuara ne kete statut ose nga organet e Shoqerise.
- 12.3 Cdo aksionar mund te perfaqesojet ne Asamblee e Pergjithshme nga nje person tjeter, jo domosdoshmerish aksionar, ne baze te nje prokure me shkrim. Ne cdo rast, prokura mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblee se Pergjithshme, dhe eshte e vlefshme per cdo thirrje te saj.
- 12.4 Nje aksionar nuk mund te leshoje nje prokure per nje pjese te aksioneve kur ai eshte i pranishem dhe te votoje personalisht per pjesen tjeter te ketyre aksioneve.

Neni 13.

Thirja, mbledhja dhe drejtimi i Asamblee

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Keshilli i Administrimit sa here qe te jete e nevojshme per interesat e Shoqerise ose ne rast se kerkohet nga aksionaret qe zoterojnë te

- pakten 5% (pese perqind) te kapitalit ose Ligji. Ne cdo rast, Asambleja e Pergjithshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda muajit Qershori, me qellim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor te vitit ushtrimor te meparshem.
- 13.2 Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme duhet te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, te derguar ne adresen e aksionareve te regjistruar ne regjistrin e aksionareve, ose me poste elektronike me njoftim marrjeje ne adresen elektronike te aksionareve te pakten 21 (njezet e nje) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e asamblese.
- 13.3 Njoftimi duhet te permbate informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyrat e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.
- 13.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet ne nje vendndodhje te ndryshme nga selia e Shoqerise, brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.
- 13.5 Njoftimi duhet te permbate informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyrat e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.
- 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e personave ne vende te ndryshme, nepermjet nje telekonference apo video konference, ose mjete te tjera elektronike te ngjashme, me kusht qe te gjithe te pranishmit te mund te identifikohen dhe t'u jepet mundesa per te ndjekur diskutimet, per te marre pjese ne to si dhe per te konsultuar e shkembyer dokumente.
- 13.7 Asambleja e Pergjithshme drejtohet nga nje aksionar i emeruar me votim nga shumica e aksionareve te pranishem ose te perfaquesuar ne mbledhje. Gjithashtu, Asambleja e Pergjithshme duhet te emeroje nje sekretar, i cili mund te mos jete domosdoshmerish nje prej aksionareve.
- 13.8 Kryetari i mbledhjes ka kompetencia te plota per te kontrolluar prokurat dhe vlefshmerine e tyre, te drejten e aksionareve dhe perfaquesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, dhe per te percaktuar nese asambleja eshte mbledhur rregullisht dhe nese eshte arritur kuromi i domosdoshem per te marre vendime te vlefshme.

- 13.9 Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe peraktuar metodat, procedurat e votimit dhe numerimit te votave. Verbalizimi ne procesverbalin e mbledhjes i diskutimeve, i kuorumi te pjesemarrjes dhe te vendimarrjes, nga ana e Kryetarit te mbledhjes dhe Sekretarit perben prove perfundimtare te ketyre fakteve, me perjashtim te rastit kur nje aksionar kerkon shprehimisht te verbalizohet tekstualisht qendrimi i tij ose kundershton menyren e numerimit te votave te aplikuar nga Kryetari. Ne kete rast ne procesverbal verbalizohet cfare eshte kerkuar shprehimisht nga aksionari dhe numerimi i votave kryhet duke verbalizuar cdo vote.
- 13.10 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesemarresve do te pergatiten pas cdo asambleje dhe do te nenshkuhen nga kryetari dhe sekretari i asamblese, si edhe noteri nese kjo kerkohet nga ligji apo nga shumica e aksionareve.

Neni 14.

Kuorumi dhe kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

- 14.1 Asambleja e Pergjithshme ka kompetencat qe Ligji dhe ky Statut i njohin shprehimisht asaj. Te drejtat e votes ne Asamblene e Pergjitheshme do te ushtrohen vetem nga aksioneret te cilet zoterojne 80 aksionet e zakonshme. Ne perputhje me parashikimet ligjore, per qellimin e llogaritjes se kuorumi dhe te votave te cilat nevojiten per miratimin e vendimeve, perqindja e te drejtave te votes ne Asamblene e Pergjitheshme per secilin nga aksionaret me te drekte vote do te jete si me poshte:
- (a) Z. Edmond Leka ka 43.75% te votave ne Asamblene e Pergjitheshme;
(b) Z. Niko Leka ka 43.75% te votave ne Asamblene e Pergjitheshme;
(c) Z. Varuzhan Piranjani ka 12.5% te votave ne Asamblene e Pergjithshme.
- 14.2 Pervec rasteve te parashikuara ne nenin 14 paragrafi i 3 i ketij Statuti, vendimet e Asamblesese Pergjithshme jane te vlefshem nese merren me voten pro te aksionareve qe perfaqesojne te pakten 50% plus 1 vote te kapitalit te Shoqerise.
- 14.3 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me ceshtjet e meposhtme jane te vlefshem nese merren me voten pro te aksionareve qe perfaqesojne te pakten 75% te kapitalit themeltar te Shoqerise:
- modifikimi i Statutit;
 - zmadhimi e zgjedhimi i kapitalit te Shoqerise;
 - krijimi i kategorive te reja te aksioneve apo ndryshimi i tyre;

- d. shnderrimi, riorganizimi, likuidimi dhe prishja e Shoqerise;
- e. bashkimi, perthithja ose ndarja e Shoqerise;
- f. emetimi i obligacioneve te konvertueshme dhe i obligacioneve;
- g. vendimet per shperndarjen ose mos shperndarjen e dividenteve;
- h. transferimi i aksioneve ose te drejtave te lidhura me to te parashikuara ne nenin 10.1 te Statutit ne lidhje me transferimin e aksioneve;
- i. rastet e tjera te parashikuara shprehimisht dhe ne menyre te paderogueshme nga Ligji.

Kreu IV

Keshilli i Administrimit

Neni 15.

Perberja e Keshillit te Administrimit

- 15.1 Keshilli i Administrimit ("Keshilli") perbehet nga 3 deri ne 5 anetare numri i te cileve percaktohen nga Asambleja e Pergjithshme qe emeron anetaret e Keshillit. Keshilli percakton nder anetaret e tij Kryetarin dhe Nen/Kryetarin. Mandati i anetareve te Keshillit zgjat 3 (tre) vjet dhe mund te shtyhet deri ne mbledhjen e radhes ne te cilen, sipas afateve te legjisacionit te fuqi, Asambleja e Pergjithshme do te miratoje illogarite financiare (rezultatet) e vitit finanziar paraardhes.
- 15.2 Keshilli i Administrimit ne momentin e miratimit te ketij Statuti, perbehet nga individet si me poshitë:
- **Z. Edmond Leka** shtetas shqiptar, i biri i Vlash, lindur me 17/05/1963 ne Tirane, Shqiperi dhe aktualisht banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr.025080556 dhe nr. personal G30517148A; ne cilesine e Kryetarit.
 - **Z. Niko Leka** shtetas shqiptar, i biri i Vlash, lindur me 31/03/1961 ne Tirane, Shqiperi dhe aktualisht banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr.033380369 dhe nr. personal G10331096G; ne cilesine e Nen-Kryetarit.
 - **Z. Varuzhan Piranjani**, shtetas shqiptar, i biri i Vahram, lindur me 22/03/1957 ne Tirane, Shqiperi dhe aktualisht banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr.024456745 dhe nr. personal F70322089G; ne cilesine e Anetarit.

Neni 16.

Mbledhjet e Keshillit te Administrimit

- 16.1 Keshilli mblidhet sa here qe eshte e nevojshme, ne perputhje me kerkesat e legjisacionit shqiptar, por jo me pak se 4 (kater) here ne vit. Kryetari therret mbledhjet e Keshillit dhe drejton seancat. Ne rast te mungeses se Kryetarit, mbledhjet e Keshillit thirren dhe

drejtohen nga Nen/Kryetari. Mbledhjet e Keshillit thirren edhe me kerkesen e te pakten dy nga anetareve te tij. Procedura e thirrjes se mbledhjes se Keshillit do te jetë nepermjet njoftimit me shkrim derguar anetareve te Keshillit jo me pak se 3 (tre) Dite Pune perpara, se bashku me rendin e dites dhe te gjitha materialet dhe dokumentet e nevojshme per mbledhjen. Ne rast urgjencë, mbledhja mund te thirret edhe 1 (nje) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen.

- 16.2 Ne cdo mbledhje te Keshillit, kuorumi i kerkuar do te konsiderohet se ekzision nese te pranishem jane me shume se $\frac{1}{2}$ e anetareve dhe vendimet do te miratohen me voten miratuese te shumices se anetareve te pranishem ne mbledhje.
- 16.3 Cdo anetar ka nje vote te barabarte ne Keshill, Kryetari i Keshillit ka voten vendimtare ne rast barazimi votash. Me qellim reflektimin e diskutimeve dhe vendimeve te marra ne mbledhje nga Keshilli, mbahen procesverbale, te cilat duhet te firmosen nga anetaret pjesemarres ne mbledhje. Ne procesverbale duhet te pasqyrohet gjithashtu edhe mendimet kunder vendimeve te marra.
- 16.4 Keshilli ka te gjitha kompetencat dhe tagrat ne lidhje me administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem i cili eshte i nevojshem per arritjen e qellimeve te Shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe i rezervohen organeve te tjera nga Ligji ose Statuti. Keshilli mund t'ia delegoje pjeserisht keto tagra dhe kompetencia administratorit te Shoqerise ose prokuratoreve te posacem te saj.
- 16.5 Keshilli eshte perjegjes, nder te tjera, edhe per kontrollin dhe mbikeqyrjen e administrimit te Shoqerise me qellim qe te siguroje qe aktiviteti i Shoqerise dhe veprimtaria e saj te jene ne perputhje me Ligjin dhe kete Statut. Keshilli, nder te tjera, ka kompetencen qe te kryeje inspekte me kontrolle ne cdo kohe qe do ta mendoje te nevojshme si dhe te kerkoje te gjitha dokumentet qe i konsideron te nevojshme per permbushjen e detyrate te tij. Keshilli mund te miratoje, rregullore per proceduren e funzionimit te mbledhjeve si dhe te vendimarrjes ne to, ne perputhje me ligjin dhe Statutin.
- 16.6 Keshilli mund te krijoje komitete te posacme, te perbera nga anetaret e tij, per te perqatitur mbledhjet apo vendimet ose per te kryer funksione mbikeqyrje te caktuara. Komitetet i raportojne Keshillit.
- 16.7 Anetareve te Keshillit do te mund t'iu paguhen shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e organeve te shoqerise ose te komiteteve te tyre, ne lidhje me permbushjen e detyrate te ngarkuara dhe funksioneve.

16.8 Keshilli, nder te tjera, me qellim listues dhe jo shterues, ushtron edhe funksionet e meposhtme te cilat nuk mund t'i delegohen administratorit ose te treteve:

- a. Emeron dhe shkarkon Administratorin/ret;
- b. Pergatit, me kerkese te Asamblese se Pergjithshme, marrjen e masave, qe jane ne kompetence te kesaj te fundit, i rekomandon asaj vendime te nevojshme per t'u marre, si dhe zbaton vendimet e Asamblese se Pergjithshme;
- c. Therret mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme sa here vleresohet e nevojshme per interesat e Shoqerise;
- d. Kujdeset qe Shoqeria te respekoje ligjin dhe standartet e kontabilitetit;
- e. Miraton planin vjetor te aktivitetit dhe te buxhetit vjetor te Shoqerise;
- f. Shqyrton e kontrollon librat kontabel, raportet e Administratorit/eve, dokumentet dhe aktivet e Shoqerise;
- g. Siguron qe pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurise se veprimtarise, si dhe detyrimet e tjera te raportimit e publikimit, te detyrueshme ne baze te ligjit apo statutit, te kryhen dhe mbahen me saktesi nga administratori/ret. Keto dokumente duhet te miratohen nga Keshilli per t'iu paraqitur Asamblese se Pergjitheshme, se bashku me nje raport te Keshillit per miratim dhe nje pershkrim per mbikeqyrjen e administrimit gjate te gjithe vitit finanziar;
- h. Siguron qe auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabel te kryhet te pakten nje here ne vit nga eksperti kontabel i autorizuar, i pavarur, dhe reporti i auditimit, drejtuar Asamblese se Pergjithshme, t'u vihet ne dispozicion te gjithe anetareve te Keshillit. Raporti i Keshillit, permendur ne paragrafin 16.7 (h) te ketij neni, duhet te permboje edhe mendimin per reportin e auditimit;
- i. Miraton marrjen persiper te detyrimeve me vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, sic rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara, nepermjet cfareadolloj instrumenti te borxhit;
- j. Miraton propozimin per themelimin e shoqerive tregtare ose te grupeve te reja si dhe cdo lloj pjesemarje ne kapitalin e shoqerive te tjera.
- k. Miraton paraprakisht cdo qendrim vendimarres te Shoqerise ne cilesine e ortakut/aksionarit te shoqerive te tjera tregtare apo grupeve;

1. Miraton rregulloret e brendshme te Shoqerise;
- m. Kryen veprime te tjera, te percaktuara ne Ligj dhe ky Statut.



Administratoret

Neni 17.

Emerimi i Administratoreve

- 17.1 Keshilli zgjedh nje ose me shume individe si Administratore te Shoqerise per nje periudhe 3 (tre) vjecare, ne pajtim me parashikimet e nenit 158 te Ligjit. Ne rast te mbarimit te afatit te mandatit te Administratorit, ai do te vazhdoje te jete ne detyre deri ne momentin kur emerimi i administratorit te ri behet efektiv.
- 17.2 Ne perputhje me Nenin 158 (2) dhe 207 te Ligjit Administratoret e Shoqerise meme nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar dhe anasjelltas. Emerimet e bera ne kundershtim me kete dispozite do te jene te pavlefshme.
- 17.3 Administratori i Shoqerise ne momentin e miratimit te ketij Statuti, eshte:

Z. Niko Leka shtetas shqiptar, lindur me 31/03/1961 ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i kartes se identitetit me nr.033380369 dhe nr. personal G10331096G.

Neni 18.

Kompetencat e Administratorit/eve

- 18.1 Administratori do te jete perjegjes per ceshtjet e administrimit te perditshem te Shoqerise, ne perputhje me kompetencat dhe tagrat e percaktuara nga ky Statut dhe Keshilli i Administrimit. Shoqeria merr persiper angazhime me nenshkrimin e Administratorit, sipas kufizimeve te parashikuara nga Ligji, Statuti dhe vendimi perkates i Keshillit.
- 18.2 Ne rastin kur Shoqeria ka me shume se nje Administrator, ndarja dhe percaktimi i kompetencave midis tyre do te behet me vendim te Keshillit. Cdo delegim kompetencash nga Administratoret mund te kryhet ne perputhje me kushtet qe mund te vendosi Keshilli. Administratoret nuk mund te delegojne detyrimet e tyre ligjore dhe statutore si dhe ato te ngarkuara nga Keshilli, me perjashtim te rastit kur vendimi i ketij te fundit parashikon shprehimisht ndryshe.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Niko Leka".

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "WJ".

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "AA".

Neni 19.

Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve

- 19.1 Nese Keshilli vendos te shperbleje Administratorin/et, Administratori/ret do shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Keshilli ne perputhje me parashikimet e nenit 160 te Ligjit.
- 19.2 Administratorit/eve mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e organeve te shoqerise ose te komitetete te tyre, ne lidhje me permbushjen e detyrave te ngarkuara dhe funksioneve.

Neni 20.

Konflikti i Interesit

- 20.1 Administratori/et nuk do te lidhe/in marreveshje ose do te hyje/ne ne marredhenie te tjera me Shoqerine ne te cilat ata kane, direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material dhe/ ose qe eshte apo mund te jete ne kundershtim me interesat e Shoqerise, me perjashtim te rastit kur respektohet nenii 13 i Ligjit dhe, ne vecanti, deri ne momentin kur miratohet nga Keshilli dhe i njoftohet sipas ligjit Asamblese se Pergjitheshme.
- 20.2 Parashikimet e mesiperme, ne perputhje me nenin 13 te Ligjit, aplikohen edhe ne rastin kur ne konflikt interesi real ose potencial ne lidhje me Shoqerine ose vendimin perkates te saj ndodhet edhe nje anetar i Keshillit. Ne kete rast, anetari Keshillit ne konflikt interesi nuk duhet te marre pjese ne votimin per miratimin e veprimit ne fjale dhe nuk llogaritet ne kuorum.

Neni 21.

Procesverbalet e mbledhjeve dhe regjistrat

- 21.1 Administratori/et kujdesen per mbajtjen e regjistrat te aksionareve si dhe qe ne libra te posacem te mbahen procesverbalet e te gjitha mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme dhe te Keshillit.

Neni 22.

Eksperti kontabel i autorizuar

- 22.1 Auditimi i Jashtem i Shoqerise kryhet nga nje me shume eksperte kontabel te autorizuar te emeruar nga Asambleja e Pergjithshme per nje vit. Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, Eksperti Kontabel i Shoqerise eshte shoqeria ALB BB AUDITING me nr. NIPT K31517001I dhe nr. Licence 97.



Handwritten signatures of the members of the Board of Directors, including C. Buz, J. H., D., M. K., and M. F.



Neni 23.

Viti finanziar

- 23.1 Viti finanziar fillon me janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti.

Neni 24.

Fitimet

- 24.1 5% (pese perqind) te te ardhurave neto sikurse rezultojne prej pasqyrave financiare vjetore do te zbriten dhe ruhen si rezerve ligjore, deri sa kjo rezerve te jete e barabarte me 10% (dhjete perqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqerise. Pjesa e mbetur do te mund te perdoret ne baze te vendimit perkates te Asamblese se Pergjithshme per t'u shperndare si dividend apo dhe per qellime e tjera te cilat do te konsiderohen si me te nevojshme apo pershtatshme prej saj.
- 24.2 Asambleja e Pergjithshme mund te vendose te krijoje rezerva te tjera te jashtezakonshme ose specifike.
- 24.3 Pas plotesimit te parashikimeve te neneve 127 dhe 128 te Ligjit, shoqeria me shumice te kualifikuar te votave te Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te aksionereve. Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje aksion nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me aksionin.

Neni 25.

PRISHJA - LIKUIDIMI

- 25.1 Shoqeria mund te prishet per shkaqet e parashikuara nga ligji. Ne rast prishjeje, Asambleja e Pergjithshme, ne perputhje me nenin 14.3, emeron nje ose me shume likuidatore duke u caktuar kompetencat perkatese.
- 25.2 Likuidatori/et te cilet do te hartojne raportin perfundimtar mbi aktivet dhe detyrimet e Shoqerise, dhe mbi procedurat dhe kohen e duhur per procesin e likuidimit.
- 25.3 Ne perfundim te procedurave te likuidimit, Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bilancin perfundimtar, punen e kryer nga likuiduesit dhe perfundimin e procesit te likuidimit ne perputhje me nenin 10.3.



Neni 26.


Njoftimet

- 26.1 Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrim ose nepermjet komunikimit elektronik ne adresat e regjistruar te Shoqerise dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin, me perjashtim te rasteve kur ky Statut parashikon shprehimisht ndryshe.
- 26.2 Shoqeria mund te njoftoje nje aksionar personalisht ose duke e derguar njoftimin me leter porosi me kthim per gjigje ne adresen e regjistruar te aksionarit qe i eshte njoftuar shoqerise nga ky i fundit. Kur ka disa bashkezoterues te nje aksioni, te gjitha njoftimet i jepen perfaquesuesit te tyre te perbashket sipas Ligjit.


Neni 27.

Dispozita Perfundimtare


- 27.1 Ceshtjet qe nuk parashikohet shprehimisht nga ky Statut do te rregullohen nga ligji shqiptar per Shoqerite Tregtare.




Z. Edmond Leka



Z. Niko Leka



Z. Gjergji Misha



Z. Varuzhan Piranjani



04. 29.08.2018



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTE RIA
Nr. 401 Rep.

VERTE TIM

Sot ne daten 29.08.2018 (dymije e tetembedhjete), une notere Eriketa Kokoli, notere ne Tirane , me Seli ne Rrugen " Sami Frasherri" vertetova nenshkrimet e vena ne Statutin e Shoqerise Akacionare " Union Grup"SHA , te aksionereve te saj :

- **Z.Eduart Shima**, atesia Fejzulla, lindur ne Tirane me 06.11.1960, banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjofimit me numer 028595970.
- **Gjergji Misha**, atesia Niko, lindur ne Bukuresht (Rumani) më 11 maj 1957, banues në Tiranë, madhor dhe me zotesi te plete juridike, mbajtës i ID me numner 029526535.
- **Z.Niko Leka, atesia** Vlashit, lindur ne Tirane me 31.03.1961, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plete juridike, mbajtes i leternjofimit me numer 033380369 ;
- **Edmond Leka**, atesia Vlash, lindur ne Tirane, me 17.05.1963, banues ne Tirane, me leternjoftim nr. 025080556 dhe numer personal G30517148A, madhor dhe me zotesi te plete juridike,
- **Varuzhan Piranjani**, atesia Vahramit, lindur ne Tirane me 22.03.1957, banuese ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plete juridike, mbajtes i leternjofimit me numer 024456745.


Une noteri pasi e gjeta konform nenit 39 te Ligjes 7829 date 01.06.1994 " Per Noterine " e vertetova si me poshte.



NOTE RE
ERIKETA KOKOLI

Kokoli

**Vendim i Asamblese se Pergjitheshme te Ortakeve
te Shoqerise
"UNION GRUP" Shpk**



Sot, me date 29.08.2018, ne perputhje me Statutin dhe me legjislacionin ne fuqi, mblidhet Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te shoqerise "UNION GRUP" Shpk, nje shoperi me perjegjesi te kufizuar, e themeluar ne perputhje me legjislacionin shqiptar me date 25.05.2001, dhe me numer regjistrimi prane Qendres Kombetare te Regjistrimi (NIPT): K61527801R (ne vijim referuar si "**Shoqeria**"), me pjesemarrjen e ortakeve si me poshte:

- **Z. Eduard Shima** shtetas shqiptar, i biri i Fejzulla, lindur me 06/11/1960 ne Tirane, Shqiperi dhe aktualisht banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr.028595970 dhe nr. personal G01106095G, zoterues i kuotes që përfaqëson 10% të kapitalit të Shoqërisë;
- **Z. Gjergji Misha**, shtetas shqiptar, i biri i Niko, lindur me 11/05/1957 ne Bukuresht, Rumani dhe banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr.029526535 dhe nr. personal F70511036N, zoterues i kuotes që përfaqëson 10% të kapitalit të Shoqërisë;
- **Z. Niko Leka** shtetas shqiptar, i biri i Vlash, lindur me 31/03/1961 ne Tirane, Shqiperi dhe aktualisht banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr.033380369 dhe nr. personal G10331096G, zoterues i kuotes që përfaqëson 35% të kapitalit të Shoqërisë;
- **Z. Edmond Leka** shtetas shqiptar, i biri i Vlash, lindur me 17/05/1963 ne Tirane, Shqiperi dhe aktualisht banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr.025080556 dhe nr. personal G30517148A, zoterues i kuotes që përfaqëson 35% të kapitalit të Shoqërisë;
- **Z. Varuzhan Piranjani**, shtetas shqiptar, i biri i Vahram, lindur me 22/03/1957 ne Tirane, Shqiperi dhe aktualisht banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr.024456745 dhe nr. personal F70322089G, zoterues i kuotes që përfaqëson 10% të kapitalit të Shoqërisë.

Se bashku te referuar si "**Ortaket**", te mbledhur me qellim per te vendosur ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve si vijon:


Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, pasi verejti se:

- Asambleja e Pergjithshme po vendsos ne lidhje me çeshtje te parashikuara ne Statutin e Shoqerise dhe ne legjislacionin perkates, ne pranine e Ortakeve te cilet perbejne kuorumin e nevojsphem ligjor per te marre vendime te vlefshme;
- Nenshkruesit e ketij vendimi kane kompetencat e nevojshme per te marre pjesa ne mbledhje dhe nenshkruar vendimin me shkrim;
- Mbledhja konsiderohet si e thirrur dhe e mbajtur ne menyre te vlefshme, me unanimitet nga te gjithe ortaket, paveresisht ndonje procedure formale per thirrjen e mbledhjes;

Mblidhet per te vendosur per çeshtjet ne vijim:

- (i) miratimin e shnderrimit te formes se Shoqerise, nga shoperi me perjegjesi te kufizuar ne shoperi aksionare sipas raportit te paraqitur nga Administratoret;
- (ii) miratimin e statutit te ri te shoqerise ne perputhje me formen e re ligjore te Shoqerise;
- (iii) miratimin e anetareve te Keshillit te Administrimit dhe Administratorit te Shoqerise;




Pas diskutimeve mbi çeshtjet e rendit te dites, paraqitjes se raportit te hartuar nga Administratoret dhe informacioneve te marra ne lidhje me to, Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve me votim unanim, ne perfaqesim te 100% te kapitalit dhe te te drejtave te votave ne Shoqeri, eshte dakort te marre vendimin si me poshte:

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve:


V E N D O S I

- (i) Miratimin e Raportit te Administratoreve si dhe miratimin e shnderrimit te formes se Shoqerise, nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri aksionare sipas strukture se ndarjes se kapitalit te paraqitur ne Raportin e Administratoreve;
- (ii) Miratimin e statutit te ri te shoqerise ne perputhje me formen e re ligjore te Shoqerise, (bashkelidhur);
- (iii) Miratimin e emerimeve te anetareve te Keshillit te Administrimit dhe te Administratorit sipas statutit te ri bashkelidhur;
- (iv) Autorizimin per administratoret e shoqerise qe vecmas ose bashkerisht te fillojne procedurat e regjistrimit te ketij vendimi ose qe vecmas ose bashkerisht te autorizojne persona te trete per kryerjen e ketyre veprimeve.


Ne perfundim te procesit te votimit, mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme te Ortakeve deklarohet e myllur dhe ky vendim pasi u hartua dhe u lexua, nenskruhet me vullnet te plote nga te gjithe Ortaket e pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje.

Ortaket


Edmond Leka




Varuzhan Piranjani




Gjergji Misha



Niko Leka



Eduard Shima





REPUBLIKA E SHQIPERISE
N O T E R I A
Nr. 145 Rep.

V E R T E T I M

Sot ne daten 29.08.2018 (dymije e tetembedhjete), une notere Eriketa Kokoli, notere ne Tirane , me Seli ne Rrugën “ Sami Frasherri” vertetova nenshkrimet e vena ne Vendimin e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise “ Union Grup”Shpk te dates 29.08.2018 te ortakeve te saj :

- **Z.Eduart Shima**, atesia Fejzulla, lindur ne Tirane me 06.11.1960, banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjoftimit me numer 028595970.
- **Gjergji Misha**, atesia Niko, lindur ne Bukuresht (Rumani) më 11 maj 1957, banues në Tiranë, madhor dhe me zotesi te plete juridike, mbajtës i ID me numner 029526535.
- **Z.Niko Leka, atesia Vlashit**, lindur ne Tirane me 31.03.1961, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plete juridike, mbajtes i leternjoftimit me numer 033380369 ;
- **Edmond Leka**, atesia Vlash, lindur ne Tirane, me 17.05.1963, banues ne Tirane, me leternjoftim nr. 025080556 dhe numer personal G30517148A, madhor dhe me zotesi te plete juridike,
- **Varuzhan Piranjani**, atesia Vahramit, lindur ne Tirane me 22.03.1957, banuese ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plete juridike, mbajtës i leternjoftimit me numer 024456745.

Une noteri pasi e gjeta konform nenit 39 te Ligjes 7829 date 01.06.1994 “ Per Noterine “ e vertetova si me poshte.

N O T E R E
ERIKETA KOKOLI